



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry of
Internal Affairs

**STRATEGJIA KOMBËTARE
KUNDËR TRAFIKIMIT ME NJERËZ NË KOSOVË
2022-2026**

29/03/2022

Përmbajtja:

- 1.1. Përmbledhje ekzekutive**
- 1.2. Hyrja**
- 1.3. Metodologjia e punës**
- 1.4. Historiku (sfondi)**
- 1.5. Objektivat strategjikë**
- 1.6. Aranzhimet e zbatimit, monitorimit dhe raportimit**
- 1.7. Ndikimi buxhetor dhe zbatimi i strategjisë**

1.1 Përmbledhje ekzekutive

Strategjia Kombëtare Kundër Trafikimit me Njerëz është dokument strategjik i cili përcakton politikat dhe masat që duhet të ndërmerren kundër krimit të trafikimit me njerëz në Kosovë. Kjo strategji dhe plani i veprimit reflektojnë prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës për luftimin e të gjitha formave të trafikimit përmes mekanizmave institucionalë. Kjo Strategji gjithashtu reflekton zotimet e Qeverisë për bashkëpunim ndërkombëtar në fushën e luftimit të trafikimit dhe obligimet që rrjedhin nga procesi i integritetit të Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian, respektivisht për zbatimin e obligimeve që dalin nga Marrëveshja për Stabilizim-Asociim mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Objektivat strategjikë dhe ata specifikë janë përcaktuar pas një procesi të konsultimit me të gjithë aktorët e brendshëm institucionalë në luftën kundër trafikimit me njerëz, si dhe me aktorët e tjerë të jashtëm si shoqëria civile, bota akademike dhe partnerët ndërkombëtarë. Strategjia gjithashtu është bazuar në analizat paraprake të realizuara në bashkëpunim me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë, në veçanti TIP raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit dhe raporti i GRETA-s i vitit 2021, në vlerësimin e zbatimit të Strategjisë, të Planit të Veprimit 2015-2019, raporteve të punës për Autoritetin Kombëtar të viteve 2020 – 2021 dhe rekomandimet e dala nga ky vlerësim.

Ky dokument strategjik ndahet në dy pjesë: Strategjia Kundër Trafikimit dhe Planin e Veprimit, i cili përmban objektivat strategjikë, ata specifikë, si dhe aktivitetet të cilat planifikohen të përmbushen në periudhën trevjeçare 2022-2024. Objektivat strategjikë dhe specifikë, si dhe aktivitetet janë të paraqitura në detaje në Planin e Veprimit, i cili po ashtu përmban pjesën buxhetore, indikatorë të matshëm dhe konkretë, si dhe përshkruan në detaje institucionet përgjegjëse dhe rolin e tyre në luftimin e trafikimit me njerëz në Kosovë. Pjesë të rëndësishme të Strategjisë përmbajnë edhe llogaritjet e ndikimeve

financiare të cilat janë diskutuar me grupin punues dhe janë reflektuar me secilin institucion përkatës.

Në Strategjinë Kombëtare Kundër Trafikimit me Njerëz 2022-2026 rekomandohen veprime dhe masa konkrete me qëllim të adresimit të sfidave të identifikuara dhe përmirësimit të gjendjes në parandalimin dhe luftimin efikas të trafikimit. Në këtë drejtim, janë paraparë veprime në funksion të përmirësimit të mekanizmit kombëtar, të zbatimit të veprimeve të koordinuara drejt parandalimit dhe vetëdijesimit për pasojat e trafikimit, fuqizimit të sistemit nga identifikimi i viktimës deri në ri-integrimin afatgjatë, ngritjes së efikasitetit në ndjekjen penale të kryesve të krimit të trafikimit me njerëz, si dhe fuqizimit të bashkëpunimit regional dhe ndërkombëtar. Të gjitha këto veprime janë rekomanduar si rezultat i vlerësimit të situatës aktuale në vend dhe në kontekst rajonal e global në raport me trafikimin, i rezultateve të analizave gjithëpërfshirëse të dokumenteve strategjike dhe analizave tjera empirike të dala nga hulumtimet e ndryshme të realizuara gjatë viteve të kaluara. Rrjedhimisht, adresimi i veprimeve të rekomanduara pritet të ketë ndikim pozitiv në adresimin e boshllëqeve të identifikuara në sistem, duke mundësuar njëkohësisht avancimin dhe fuqizimin e parandalimit dhe luftimit të dukurisë së trafikimit.

Plani i Veprimit është hartuar në përputhje me objektivat strategjike, objektivat specifike dhe aktivitetet e planifikuara që do të ndihmojnë në përmbushjen e objektivave specifike drejt arritjes së objektivave strategjike.

1.2 Hyrje

Trafikimi me njerëz është një dukuri shqetësuese për më shumë se dy dekada në Kosovë, dukuri e cila ka evoluar dhe ndryshuar në format dhe trendët e saj. Hartimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit Kundër Trafikimit me Njerëz 2022-2026 është një obligim që rrjedh nga prioritetet që kanë përcaktuar institucionet e Republikës së Kosovës, për të parandaluar dhe luftuar krimin e organizuar dhe të gjitha format e shfaqjes së tij. Si e tillë, Strategjia Kombëtare Kundër Trafikimit me Njerëz 2022-2026 është hartuar në përputhje me Programin e Qeverisë 2021-2025,¹ si dhe në përputhje me reformat që janë duke u ndërmarrë në kontekst të procesit të integrimit Evropian dhe obligimeve të tjera ndërkombëtare. Programi i Qeverisë ka paraparë fuqizimin e sistemit të drejtësisë duke u fokusuar në rritjen e sundimit të ligjit, rrjedhimisht edhe në luftimin e trafikimit me qenie njerëzore si një nga parimet themelore për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të qytetarëve, të garantuara me Kushtetutë dhe me konventa ndërkombëtare. Prioritet tjetër në kuadër të programit të qeverisë është fuqizimi i bashkëpunimit me shtetet fqinje dhe më gjerë, si dhe me mekanizmat ndërkombëtarë për zbatim të ligjit, me qëllim të harmonizimit të veprimeve dhe sigurimit të qasjes së bashkërenduar në adresimin e problemit të trafikimit me njerëz, si dhe forcimin e rolit si kontribuues për paqen, sigurinë dhe zhvillimin ndërkombëtar.²

Institucionet e Republikës së Kosovës trajtojnë dukurinë e trafikimit me njerëz me shumë seriozitet dhe përkushtim, duke krijuar struktura të qëndrueshme, bazë ligjore dhe politika efikase për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz, si dhe sigurimin e shërbimeve për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të trafikimit. Me gjithë arritjet e shënuara, mbetet që me këtë Strategji Kombëtare ndër të tjera të vazhdohet të fuqizohen më tutje veprimet kundër trafikimit.

¹ Shih po aty, Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, 2021-2025, prioritetet në forcimin e sundimit të ligjit në Kosovë, faqe 12.

² Po aty.

Kosova ka zhvilluar një kornizë të mirëfilltë ligjore dhe strategjike në drejtim të luftimit të trafikimit duke përfshirë edhe mekanizmat institucionalë të mandatuar të koordinojnë dhe zbatojnë politikat kundër trafikimit. Për më tepër, përafrimi i legjislacionit me legjislacionin e BE-së vazhdon, në përputhje me Programin Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit me Bashkimin Evropian.

Strategjia është bazuar në Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit, i cili trajton të gjitha format e trafikimit me njerëz, qoftë kombëtar, ose trans-nacional, duke përfshirë veprat e kryera për qëllime të shfrytëzimit të viktimave përderisa ato përmbajnë elemente të trafikimit me njerëz.

Duke pasur parasysh që dukuria e trafikimit ka prekur edhe vendet e tjera, ku lëvizja e viktimave mund të bëhet nga një vend në vendin tjetër, shihet se bashkëpunimi ndërkombëtar është i një rëndësie të veçantë, posaçërisht shkëmbimi i përvojave dhe informatave mes vendeve.

1.3 Metodologjia

Hartimit të Strategjisë Kombëtare Kundër Trafikimit me Njerëz 2022-2026 i ka paraprirë vlerësimi gjithëpërfshirës lidhur me zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit 2015-2019, si dhe raportet e punës të Autoritetit Kombëtar të viteve 2020 – 2021. Po ashtu, janë analizuar në detaje të gjitha raportet e mekanizmave relevantë ndërkombëtarë, si Departamentit Amerikan të Shtetit, Komisionit Evropian, OSBE-së, shoqërisë civile etj.

Procesi i hartimit të strategjisë është koordinuar nga Koordinatori Kombëtar Kundër Trafikimit. Autoriteti Kombëtar, partnerët ndërkombëtarë, shoqëria civile dhe grupet tjera të interesit janë përfshirë në vlerësimin gjithëpërfshirës dhe të hollësishëm të zbatimit të Strategjisë Kundër Trafikimit me Njerëz 2015-2019. Grupi punues ka punuar në analizimin e gjendjes aktuale dhe në identifikimin e sfidave që duhet adresuar me këtë strategji, duke propozuar objektiva dhe masa të cilat do të përmirësojnë efikasitetin dhe efektivitetin e institucioneve të përfshira në zbatim me qëllim të parandalimit dhe luftimit

të trafikimit me njerëz, gjithmonë duke qenë të vetëdijshëm për aspektin trans-nacional që ky fenomen ngërthen. Strategjia e tanishme është e bazuar edhe në draftin e punuar nga grupi punues qeveritar gjatë vitit 2020-2021, mirëpo për shkak të situatës me pandeminë Covid-19 në Kosovë ky version tani është i përditësuar dhe është ri-hartuar, duke reflektuar edhe sfidat e tanishme nga analiza e situatës, si dhe bazohet në prioritetet qeveritare për periudhën 2022-2026.

Metodologjia e ndjekur në këtë proces ka përfshirë vlerësimin e zbatimit të strategjisë së kaluar 2015-2019 dhe shkallën e përmbushjes së objektivave të saj nëpërmes realizimit të aktiviteteve. Vlerësimi i realizimit të kësaj strategjie është në Shtojcën 2. Pas vlerësimit të zbatimit të strategjisë, janë identifikuar boshllëqet në realizimin e aktiviteteve të mëparshme dhe është bërë identifikimi i aktiviteteve të reja që shpijnë kah përmirësimi i përgjithshëm në fushën e parandalimit dhe luftimit të trafikimit. Përgjatë punëtorive dhe takimeve janë diskutuar dhe dhënë vlerësime për gjendjen aktuale, me ç'rast janë propozuar aktivitetet që do të ndihmonin arritjen e objektivave specifike dhe realizimin e atyre strategjike, duke propozuar përmirësime me fokus në parandalimin dhe luftimin e trafikimit në përgjithësi. Qasja ka qenë shumë-disiplinore, proaktive, si dhe në grupe punuese me aktorë institucionalë, me pjesëmarrje aktive të shoqërisë civile në adresimin e nevojave të viktimave të trafikimit me njerëz, si dhe partnerëve ndërkombëtarë kyçë, duke garantuar edhe procesin e pronësisë së këtij dokumenti strategjik.

Përcaktimi i objektivave strategjike, atyre specifike dhe aktiviteteve është bazuar në të dhënat, të gjeturat dhe rekomandimet nga procesi i vlerësimit të Strategjisë paraprake, në raportet e aktorëve vendorë dhe ndërkombëtarë, mirëpo edhe në prioritetet e identifikuarat të cilat janë në përputhje me prioritetet e Qeverisë, si dhe situatën aktuale në Kosovë në sferën e luftës kundër trafikimit. Hartimi i strategjisë ka kaluar nëpër një proces konsultativ ndër-ministror, si dhe ka kaluar nëpër konsultime publike. Gjatë përcaktimit të objektivave strategjike, kujdes i veçantë i është kushtuar shmangies së dyfishimit të mundshëm të aktiviteteve, si dhe ndërlidhjes së kësaj strategjie me

strategjitë e tjera shtetërore dhe sektoriale të miratuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Institucionet të cilat kanë qenë pjesë e hartimit të kësaj strategjie janë:

1. Zyra për Planifikim Strategjik pranë Zyrës së Kryeministrit;
2. Ministria e Punëve të Brendshme;
3. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
4. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve;
5. Ministria e Shëndetësisë;
6. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
7. Ministria e Ekonomisë;
8. Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
9. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
10. Përfaqësues nga OSBE;
11. Përfaqësues nga ICITAP dhe OPDAT - Ambasada e SHBA-së;
12. Përfaqësues nga GIZ;
13. Përfaqësues nga KE;
14. Ekspertë nga Bashkimi Evropian;
15. Përfaqësues nga KPK, ZKPSH;
16. Përfaqësues nga KGJK;
17. Përfaqësues nga Organizatat Joqeveritare, si dhe partnerë të tjerë të jashtëm ndërkombëtarë (Shih listën e plotë të pjesëmarrësve të paracaktuar në Shtojcën 1).

1.4 Historiku

Trafikimi me njerëz është një nga shkeljet më të rënda të të drejtave të njeriut, i cili shpeshherë ndërlihet edhe me krimin e organizuar. Dinjiteti njerëzor radhitet si një nga vlerat themelore njerëzore në aktin më të lartë juridik, Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Prandaj, institucionet e Republikës së Kosovës janë të përkushtuara të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme pozitive për të garantuar këtë vlerë në mënyrë efektive, dhe përveç kësaj të ofrojnë mbrojtje nga fenomeni negativ i trafikimit të njerëzve dhe njëkohësisht të mbrojnë dhe të promovojnë të drejtat e njeriut për të gjitha viktimat e trafikimit, pa marrë parasysh racën, kombësinë ose gjininë.

Trafikimi me njerëz përbën krim serioz i cili shpesh ka implikime të cilat shtetet nuk mund t'i adresojnë individualisht. Si pasojë, trafikimi me njerëz rezulton të jetë një fenomen kompleks trans-nacional i cili i ka rrënjët në ndjeshmërinë ndaj varfërisë, mungesën e kulturave demokratike, pabarazinë gjinore dhe dhunën ndaj grave, tek konfliktet dhe situatat pas konflikteve, tek mungesa e integritit shoqëror, mungesa e mundësive për punësim, mungesa e qasjes në arsim, puna e fëmijëve, si dhe drejtpërdrejt tek diskriminimi gjinor.

Kosova më herët ka qenë kryesisht vend i destinimit, duke mos përjashtuar edhe rastet e transitit dhe origjinës. Ndërsa tani, Kosova mbetet kryesisht vend i origjinës (viktima nga Kosova të shfrytëzuara në Kosovë) me më pak raste të destinimit dhe transitit. Më të prekur nga trafikimi me njerëz mbeten fëmijët dhe forma më e shpeshtë e shfrytëzimit të tyre është ajo e shfrytëzimit seksual.

Viktimat	2019	2020	2021
Viktima të identifikuar	26	17	25
Viktima të asistuar-strehuara	16	09	14
Viktima të cilat nuk janë asistuar/strehuar	10	08	18
Viktima të riatdhesuara	03	03	01
Gjinia	2019	2020	2021
Femra	23	07	20
Meshkuj	03	10	05

Strategjia Kombëtare Kundër Trafikimit me Njerëz
2022-2026

Viktimat e identifikuara-origjina	2019	2020	2021
Kosovë	21	17	24
Shqipëri	1	0	01
Serbi	2	0	0
Mali i Zi	2	0	0
Totali	26	17	25

Viktimat e identifikuara sipas grup moshave								
Grup moshë	nën 18	18--22	23--25	26-30	31-35	36-40	mbi 40	Totali
Viti 2019	15	04	01	03	02	01	00	26
Viti 2020	15	01	01	00	00	00	00	17
Viti 2021	19	05	00	00	00	00	01	25

Viktimat e trafikimit sipas formës së shfrytëzimit	2019	2020	2021
Shfrytëzim për prostitucion të tjerëve	18	07	19
Shfrytëzim për pornografi dhe forma tjera të shfrytëzimit seksual	01	00	0
Shfrytëzim për shërbime apo punë të detyruar	02	10	03
Shfrytëzim për lypësi / lëmshë	01	00	03
Shfrytëzim për mbajtje në skllavëri apo kushte të ngjashme	02	00	0
Martësë e detyruar	01	00	0
Shfrytëzim për robëri apo heqje të organeve	00	00	0
Shitje e fëmijës	01	00	0

Një prej të arriturave të tjera të raportuara gjatë viteve 2019-2021 është vazhdimi i koordinimit të aktiviteteve nga Autoriteti Kombëtar dhe Koordinatori Kombëtar, puna e Drejtorisë për Hetimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore (DHTQNJ) si drejtori e profilizuar në parandalim dhe hetim të trafikimit, caktimi i koordinatorëve në shtatë prokuroritë themelore, si dhe fillimi i krijimit të “task forcave” në nivele regjionale të udhëhequra nga prokurorët koordinorë.

Përkundër rezultateve të arritura, disa sfida mbesin, e të cilat kërkojnë edhe vëmendjen e shtuar si dhe reagimin e menjëhershëm institucional, sikurse fuqizimi i koordinimit ndër-institucional, aktivitetet e koordinuara në parandalim, mbrojtje dhe ri-integrim si dhe rritja e efikasitetit në hetimin dhe gjykimin e trafikantëve dhe shqiptimin e dënimeve adekuate. Sfidë në vete mbetet bashkëpunimi ndërkombëtar dhe mos anëtarësimi në mekanizmat ndërkombëtarë të sigurisë.

Përmbledhja e aktiviteteve kryesore

Aktivitetet kryesore të Strategjisë Kundër Trafikimit me Njerëz 2022-2026 do të fokusohen në përkrahjen e viktimave në mënyrë të strukturuar dhe të qëndrueshme me aktivitete konkrete në forcimin e mekanizmave për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore, në parandalimin e trafikimit me njerëz, në përmirësimin e identifikimit, mbrojtjes dhe ri-integrimit të viktimave dhe viktimave të supozuara të trafikimit, në hetimin, ndjekjen penale dhe ndëshkimin e rasteve të trafikimit me qenie njerëzore, si dhe në fuqizimin e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar.

Për të gjitha aktivitetet e parapara në këtë Strategji, është përcaktuar kostoja dhe linja buxhetore nga ku këto aktivitete do të mbulohen financiarisht. Disa nga aktivitetet do të mbështeten nga donatorët ndërkombëtarë të cilët përkrahin fushën e luftimit të trafikimit me njerëz.

1.5 Objektivat:

Në bazë të analizave paraprake të gjendjes aktuale dhe rekomandimeve lidhur me zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit Kundër Trafikimit 2015-2019, grupi punues për hartimin e Strategjisë, ka vendosur objektivat e mëposhtëm strategjikë:

Objektivi strategjik I: Forcimi i mekanizmave institucionalë për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore (TQNJ);

Objektivi strategjik II: Parandalimi i dukurisë së trafikimit me njerëz;

Objektivi strategjik III: Përmirësimi i identifikimit, mbrojtjes dhe ri-integrimit të viktimave dhe viktimave të supozuara të trafikimit;

Objektivi strategjik IV: Hetimi, ndjekja penale dhe ndëshkimi i rasteve të trafikimit me qenie njerëzore;

Objektivi strategjik V: Fuqizimi i bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar.

Forcimi i mekanizmave institucionalë për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore (TQNJ)

Nën këtë objektivi strategjik, janë paraparë objektivat specifikë që do të ndihmojnë në realizimin e këtij objektivi:

Treguesi: Numri i aktorëve relevantë me kapacitete të ngritura në raportim dhe koordinim, si dhe rritja e efektivitetit të raportimit.

Rezultati: Koordinim dhe raportim efektiv për ofrimin e shërbimeve cilësore dhe të qëndrueshme.

Nr.	Objektivi specifik	Treguesi dhe rezultati
I.1	Ngritja e kapaciteteve reaguese të të gjithë aktorëve relevantë për ofrim të shërbimeve cilësore dhe të qëndrueshme.	Kapacitetet e ngritura të të gjithë aktorëve relevantë për ofrim të shërbimeve cilësore dhe të qëndrueshme. Së paku 150 profesionistë janë trajnuar për ofrimin e shërbimeve efektive dhe cilësore.

I.2	Fuqizimi i rolit të Koordinatorit Kombëtar, Sekretariatit të Strategjive dhe Autoritetit Kombëtar Kundër Trafikimit me Njerëz.	<p>Përqindja e institucioneve anëtare të mekanizmave koordinues qendrorë të fuqizuar e që zbatojnë në mënyrën e duhur përgjegjësitë e përbashkëta koordinuese.</p> <p>Mekanizmat koordinues qendrorë janë fuqizuar, janë funksionalë dhe efikas në zbatimin e veprimeve për parandalimin dhe mbrojtjen nga trafikimi me njerëz.</p> <p>Institucionet pjesëmarrëse të këtyre mekanizmave zbatojnë përgjegjësitë e përbashkëta në mënyrën e duhur.</p>
I.3	Fuqizimi i sistemit të grumbullimit, menaxhimit dhe vlerësimit të informatave dhe të të dhënave të mbledhura.	<p>Numri i veprimeve të realizuara sipas planifikimeve periodike dhe vjetore.</p> <p>Mbi 90% e takimeve të planifikuara janë realizuar.</p> <p>Mbi 90% e aktiviteteve të planifikuara janë realizuar.</p>

Parandalimi i dukurisë së trafikimit me njerëz

Nën këtë objektiv strategjik, janë paraparë objektivat specifike që do të ndihmojnë në realizimin e këtij objekti:

Treguesi: Ngritja e nivelit të vetëdijes së përgjithshme të publikut dhe aktorëve relevantë institucionalë dhe të shoqërisë lidhur me TQNJ.

Rezultati: Vetëdija e publikut dhe aktorëve relevantë institucionalë në lidhje me dukurinë e trafikimit me njerëz është ngritur.

Nr.	Objektivi specifik	Treguesi dhe rezultati
II.1	Përcjellja sistematike e trendëve dhe vetëdijesimi gjithëpërfshirës mbi rrezikun dhe pasojat e trafikimit me njerëz.	<p>Zgjerimi i shtrirjes së aktiviteteve me qëllim të parandalimit të trafikimit në nivel vendi.</p> <p>Identifikimi i trendëve të trafikimit dhe publikimi i rezultateve me qëllim të vetëdijesimit.</p> <p>Përfshirja me aktivitete e 70% të territorit të Kosovës (matja përmes anketimit në shkolla dhe qytete).</p>

Përmirësimi i identifikimit, mbrojtjes dhe ri-integrimit të viktimave dhe viktimave të supozuara të trafikimit

Nën këtë objektiv strategjik, janë paraparë objektivat specifikë që do të ndihmojnë në realizimin e këtij objekti:

Treguesit:

- Numri i viktimave të cilave u është siguruar mbrojtje, ndihmë dhe të cilat janë ri-integruar, në raport me numrin e përgjithshëm të viktimave të identifikuara;
- Numri i profesionistëve të trajnuar.

Rezultati: Së paku 500 profesionistë janë trajnuar mbi identifikimin, mbrojtjen dhe ri-integrimin e viktimave dhe viktimave të supozuara të TQNJ-së.

Nr.	Objektivi specifik	Treguesi dhe rezultati
III.1	Ngritja e efikasitetit dhe efektivitetit për identifikim dhe referim të hershëm.	<p>Numri i viktimave të identifikuara/referuara.</p> <p>100% e viktimave të identifikuara janë referuar dhe kanë përfituar nga shërbimet.</p>
III.2	Fuqizimi i vazhdueshëm i shërbimeve të drejtpërdrejta për	Masat e ndërmarra me qëllim të ofrimit të shërbimeve të qëndrueshme,

	viktimat dhe viktimat e supozuara të trafikimit.	të vazhdueshme dhe cilësore për viktimat dhe viktimat e supozuara të trafikimit. Ofruesit e shërbimeve kanë buxhet të mjaftueshëm, janë të trajnuar dhe u ofrojnë shërbime cilësore viktimave dhe viktimave të supozuara të trafikimit.
III.3	Lehtësimi i procedurave të kompensimit për viktimat e trafikimit.	Përqindja e rasteve që përfitojnë nga kompensimi në raport me numrin e viktimave të cilat kanë aplikuar për kompensim. Përqindja e viktimave të kompensuara.
III.4	Ri-integrimi i viktimave dhe viktimave të supozuara të trafikimit.	Numri i viktimave të ri-integruara sipas numrit të tyre në shkollim, punësim dhe kthim në familje. Së paku 90% të viktimave janë të ri-integruara.

Hetimi, ndjekja penale dhe ndëshkimi i rasteve të trafikimit me qenie njerëzore

Nën këtë objektiv strategjik, janë paraparë objektivat specifike që do të ndihmojnë në realizimin e këtij objekti:

Treguesi: Numri i personave të ndjekur penalisht.

Rezultati: Së paku 90% e rasteve të personave të ndjekur penalisht janë zgjidhur me sukses.

Nr.	Objektivi specifik	Treguesi dhe rezultati
IV.1	Ngritja e efikasitetit dhe efektivitetit institucional për hetim të rasteve të trafikimit.	Numri i rasteve të iniciuara. 100% e rasteve të iniciuara janë dorëzuar në prokurori.

IV.2	Ngritja e efikasitetit dhe efektivitetit institucional për ndjekjen penale të rasteve të trafikimit.	Numri i hetimeve të filluara. Numri i hetimeve të përfunduara.
IV.3	Ngritja e efikasitetit dhe efektivitetit institucional për ndëshkimin e veprave dhe kryesve të veprave të trafikimit dhe për konfiskimin e pasurisë.	Numri i lëndëve të pranuar në gjykatë. Numri i rasteve të konfiskimit të pasurisë. Numri i lëndëve të gjykuara dhe personave të ndëshkuar. Numri i lëndëve të konfiskimit të pasurisë.

Fuqizimi i bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar

Nën këtë objektiv strategjik, janë paraparë objektivat specifike që do të ndihmojnë në realizimin e këtij objektiivi:

Treguesi: Marrëveshjet e nënshkruara për vit

Rezultati: Rritja e bashkëpunimit regjional dhe ndërkombëtar përmes realizimit të marrëveshjeve të nënshkruara.

Nr.	Objektivi specifik	Treguesi dhe rezultati
V.1	Përmirësimi i bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e parandalimit, luftimit të trafikimit me qenie njerëzore dhe atë të ofrimit të ndihmës për viktimat.	Shkëmbimi i informatave, organizimi i takimeve të përbashkëta dhe pjesëmarrja në takime dhe konferenca. Veprime të ndërmarra çdo vit si rezultat i bashkëpunimit regjional dhe ndërkombëtar për luftimin e trafikimit me njerëz. Së paku 90% të takimeve dhe konferencave të realizuara.

1.6 Monitorimi, raportimi dhe vlerësimi i zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit

Ministria e Punëve të Brendshme do të jetë bartësi kryesor i zbatimit të Strategjisë Kundër Trafikimit me Njerëz, duke u ndihmuar nga institucionet përkrahëse. Për të monitoruar zbatimin e aktiviteteve të parapara në Planin e Veprimit të Strategjisë, do të angazhohet Sekretariati për Strategji në kuadër të MPB-së³, i cili do të përgatisë:

- **Raporte 6-mujore** për arritjen e objektivave strategjike dhe për zbatimin e Planit të Veprimit. Raporti 6-mujor do të përmbajë informata për arritjen e objektivave dhe zbatimin e aktiviteteve. Në kuadër të raportit 6-mujor, në veçanti do të nënvizohen vështirësitë e hasura, sfidat, rreziqet e identifikuar dhe adresimi i tyre për zbatimin e strategjisë;
- **Raporte vjetore** për arritjen e objektivave strategjike dhe për zbatimin e Planit të Veprimit. Raporti vjetor i progresit do të përmbajë informata për arritjen e objektivave dhe zbatimin e aktiviteteve. Në kuadër të raportit vjetor, në veçanti do të nënvizohen vështirësitë e hasura, sfidat, rreziqet e identifikuar dhe adresimi i tyre për zbatimin e strategjisë, si dhe përcjellja e indikatorëve matës dhe zbatimi i tyre.

Institucionet përgjegjëse për zbatim do të ofrojnë informata mbi progresin në zbatimin e strategjisë.

Plani vjetor do të rishikohet sipas shkallës së zbatimit/mos-zbatimit të aktiviteteve të parapara në strategji.

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë Kombëtare Kundër Trafikimit me Njerëz 2022-2026 janë:

- Ministria e Punëve të Brendshme;
- Policia e Kosovës;
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës;

³Sekretariati i Strategjive / Zyra e Koordinatorit Kombëtar: Sekretariati i Strategjive në MPB ka për detyrë të monitorojë në baza të rregullta zbatimin e Strategjisë duke mbledhur dhe analizuar të dhëna rreth zbatimit të aktiviteteve të Planit të Veprimit, si dhe duke hartuar raportet periodike dhe vlerësuese për Koordinatorin Kombëtar. Përveç këtyre, Sekretariati do të ndihmojë Koordinatorin Kombëtar për koordinim e implementimit të Strategjisë dhe komunikimin me palët e interesit.

- Këshilli Prokurorial i Kosovës;
- Ministria e Drejtësisë;
- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve;
- Ministria e Shëndetësisë;
- Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Agjencia për Barazi Gjinore;
- Prokurori i Shtetit;
- Gjykatat;
- Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave;
- Komunat, dhe
- Çdo ofrues i shërbimeve në kuadër të këtyre institucioneve që merret me parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz.

Mekanizmi i Monitorimit dhe Raportimit të Strategjisë Kombëtare Kundër Trafikimit me Njerëz 2022-2026 dhe Planit të Veprimit

Mekanizmi i monitorimit do të funksionojë në përputhje me parimet e përcaktuara në Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr. 07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit, në Doracakun për Planifikimin, Hartimin dhe Monitorimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Tyre të Veprimit.

Ministria e Punëve të Brendshme është përgjegjëse për koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të Strategjisë Shtetërore Kundër Trafikimit me Njerëz 2022-2026 dhe për ndërmarrjen e veprimeve, nëse është e nevojshme, për të siguruar zbatimin në kohë dhe në mënyrë efektive të aktiviteteve të përcaktuara në Planin e Veprimit.

Autoriteti përgjegjës për përgatitjen e raporteve sipas mandatit është Sekretariati për Monitorim dhe Evaluim të Strategjive Nacionale, përkrahur nga Koordinatori Kombëtar Kundër Trafikimit me Njerëz në kuadër të MPB-së.

Raportet e progresit që do të përgatiten:

- Raporti 6 mujor i zbatimit;
- Raporti vjetor i zbatimit;

- Raporti përfundimtar.

	Autoriteti Përgjegjës për hartimin e raportit	Afati i fundit	Finalizimi i Raportit
Raporti 6-mujor mbi zbatimin	Sekretariati për Monitorim dhe Evaluim të Strategjive Nacionale me përkrahjen e Koordinatorit Kombëtar		AKAT
Raporti vjetor i zbatimit	Sekretariati për Monitorim dhe Evaluim të Strategjive Nacionale me përkrahjen e Koordinatorit Kombëtar		Nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm (MPB)
Raporti Përfundimtar	Sekretariati për Monitorim dhe Evaluim të Strategjive Nacionale me përkrahjen e Koordinatorit Kombëtar		Nënshkruar nga Ministri i Punëve të Brendshme

Në rast të ndonjë problemi të theksuar gjatë implementimit ose në rast të rrethanave të ndryshuara, ministria përgjegjëse e informon Zyrën për Planifikim Strategjik ZPS në kohën e duhur. Ministria përgjegjëse dhe ZPS, pas vlerësimit të situatës së përbashkët, do të propozojnë veprimin e nevojshëm për Komisionin e Planifikimit Strategjik.

Strategjia Kombëtare Kundër Trafikimit me Njerëz
2022-2026

dhe Autoritetit Kombëtar Kundër Trafikimit me Njerëz. I.3 Avancimi dhe harmonizimi i kornizës ligjore dhe rregullative në përputhje me standardet ndërkombëtare.												
1.4 Fuqizimi i sistemit të grumbullimit, menaxhimit dhe i vlerësimit të informatave dhe të të dhënave të mbledhura.												
Objektivi Strategjik II: Parandalimi i dukurisë së trafikimit me njerëz												
Objektivi specifik												
II.1 Përcjellja sistematike e trendëve dhe vetëdijesimi gjithëpërfshirës mbi												

Strategjia Kombëtare Kundër Trafikimit me Njerëz
2022-2026

rrezikun dhe pasojat e trafikimit me njerëz.												
Objektivi Strategjik III: Përmirësimi i identifikimit, mbrojtjes dhe ri-integrimit të viktimave dhe viktimave të supozuara të TQNj-së												
Objektivat specifike												
III.1 Ngritja e efikasitetit dhe efektivitetit për identifikim dhe referim të hershëm.												
III.2 Fuqizimi i vazhdueshëm i shërbimeve të drejtpërdrejta për viktimat dhe viktimat e supozuara të trafikimit.												
III.3 Lehtësimi i procedurave të kompensimit për viktimat e trafikimit.												

Strategjia Kombëtare Kundër Trafikimit me Njerëz
2022-2026

III.4 Ri-integrimi i viktimave dhe viktimave potenciale të trafikimit.												
Objektivi Strategjik IV: Hetimi, ndjekja penale dhe ndëshkimi i rasteve të trafikimit me qenie njerëzore												
Objektivat specifike												
IV.1 Ngritja e efikasitetit dhe efektivitetit institucional për hetim të rasteve të trafikimit.												
IV.2 Ngritja e efikasitetit dhe efektivitetit institucional për ndjekjen penale të rasteve të trafikimit.												

Strategjia Kombëtare Kundër Trafikimit me Njerëz
2022-2026

IV.3 Ngritja e efikasitetit dhe efektivitetit institucional për ndëshkimin e veprave dhe kryerësve të veprave të trafikimit dhe për konfiskimin e pasurisë.												
Objektivi Strategjik V: Fuqizimi i bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar												
Objektivat specifike												
V.1 Përmirësimi i bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e parandalimit, luftimit të trafikimit me qenie njerëzore dhe atë të ofrimit të ndihmës për viktimat.												

Strategjia Kombëtare Kundër Trafikimit me Njerëz
2022-2026

Totali												
Nën-total 2022-2024												

Burimi i financimit të zbatimit të Planit të Veprimit do të jetë kryesisht nga buxheti i Republikës së Kosovës. Sipas Kornizës së Shpenzimeve Afatmesme Publike 2022-2024, fondet minimale për zbatimin e aktiviteteve të kësaj Strategjie do të jenë EUR XXX milion.

Shtojcat

LISTA E PJESËMARRËSVE GJATË HARTIMIT TË STRATEGJISË

DONATORËT

I. Korniza ligjore në fushën e trafikimit me njerëz

Korniza ligjore në fushën e trafikimit me njerëz është hartuar në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Fusha e trafikimit në Kosovë është e rregulluar me legjislacionin në vijim:

Kushtetuta e Republikës së Kosovës;

Kodi Penal i Republikës së Kosovës;

Kodi i Procedurës Penale të Kosovës;

Kodi i Drejtësisë për të Mitur;

Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikuara;

Ligji për Kompensimin e Viktimave të Krimit;

Ligji për Mbrojtjen e Dëshmitarëve;

Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje;

Ligji për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit;

Ligji për Përgjegjësinë e Personave Juridik për Vepra Penale;

Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Krimeve Kibernetike;

Ligji për Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar;

Ligji për Policinë e Kosovës;

Ligji për Prokurorin e Shtetit;

Ligji për Inspektoratin e Policisë së Kosovës;

Ligji për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës;

Ligji për Inspektoratin e Punës;

Strategjia Kombëtare Kundër Trafikimit me Njerëz në Kosovë;

Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve;

Strategjia për të Drejtat e Fëmijëve;

Ligji Nr. 04/L-081 për Amandamentimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare;

Ligji për Inspektoratin e Punës, 03/L-017;

Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare, 02/L-17;

Ligji për Familje, 2004/32;

Ligji mbi Ndërprerjen e Shtatzënisë, 2008/03-L-110;

Ligji për Shëndetësi;

Procedurat Standarde të Veprimit për Personat e Trafikuar në Kosovë;

Ligji për Shëndetësinë Riprodhuese;

Ligji i Punës;

Ligji për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskim të Pasurisë;

Ligji për Ndihmë Juridike Falas;

Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;

Ligji për Aftësim Profesional, Rehabilitim dhe Punësim të Personave me Aftësi të Kufizuara;

Ligji Kundër Diskriminimit;

Ligji për Barazi Gjinore;

Ligji për të Huaj;

Ligji për Azil;

Ligji për Lëshimin e Lejes së Punës dhe Punësim të Qytetarëve të Huaj në Kosovë.

Dokumentet ndërkombëtare

- 2006 Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Protokolli i saj Opsional;
- 2006 Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtje të të Gjithë Personave nga Zhdukja me Forcë;
- 2000 Protokolli për Parandalimin, Pengimin dhe Ndëshkimin e Trafikimit me Njerëz, sidomos të Grave dhe Fëmijëve, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara Kundër Krimit të Organizuar Transnacional;
- 2000 Protokolli Opsional për Konventën e të Drejtave të Fëmijës për Shitje, Prostituum të Fëmijëve;
- 1999 Konventa e ONP për Format më të Këqija të Punës së Fëmijëve Nr. 182;
- 1990 Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të të Gjithë Punëtorëve Emigrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të tyre;
- 1989 Konventa për të Drejtat e Fëmijës;
- 1984 Konventa Kundër Torturës, Trajtimeve dhe Ndëshkimeve të tjera të Egra, Jonjerëzore apo Degraduese;
- 1979 Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave;
- 1967 Protokolli për Statusin e Refugjatëve;
- 1966 Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor;
- 1966 Konventa Ndërkombëtare për të Drejta Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- 1966 Protokolli Opsional për Konventën Ndërkombëtare për të Drejta Civile dhe Politike;
- 1957 Konventa e ONP për Shfuqizimin e Punës së Detyruar Nr. 105;
- 1951 Konventa për Statusin e Refugjatit;
- 1930 Konventa e ONP për Punë të Detyruar Nr. 130;
- 2011 Konventa për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës Kundër Grave dhe Dhunës në Familje, CETS nr.210, 7 prill 2011;
- 2007 Konventa për Mbrojtjen e Fëmijës Kundër Shfrytëzimit Seksual dhe Keqtrajtimit Seksual;
- 2005 Konventa për Veprim Kundër Trafikimit me Njerëz, CETS nr. 197, 16 maj 2005;
- 1983 Konventa për Kompensim të Viktimave të Krimeve të Dhunshme, CETS nr. 116, 24 nëntor 1983;
- 1981 Konventa për Mbrojtje të Individëve rreth Procesimit Automatik të të Dhënave Personale, ETS

108, 28.1.1981;

1950 *Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Fundamentale, siç është amendamentuar me Protokollin Nr. 11, 04.11.1950;*

2010 *Direktiva për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Tij, Gazeta Zyrtare L 101/1 15.04.2011;*

2008 *Vendimi Kornizë i Këshillit 2008/977/JHA i datës 27 nëntor 2008 për mbrojtjen e të dhënave personale të procesuara në kornizën e bashkëpunimit të policisë dhe gjyqësorit për çështje penale;*

2004 *Direktiva e Këshillit 2004/81/KE e datës 29 prill 2004 për leje rezidenciale për qytetarët e vendeve të treta që janë viktime të trafikimit me njerëz apo të cilët kanë qenë objekt i një veprimi për lehtësimin e imigrimit ilegal, të cilët bashkëpunojnë me autoritetet kompetente, Gazeta Zyrtare L 261, 06 gusht 2004;*

2002 *Direktiva 2002/58/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 12 qershor 2012 lidhur me procesimin e të dhënave personale dhe mbrojtjen e privatësisë në sektorin e komunikimeve elektronike, Gazeta Zyrtare L 201/37, 31 korrik 2002;*

2001 *Vendimi Kornizë i Këshillit i 15 marsit 2001 për qëndrimin e viktimave në procedura kriminale (2001/220/JHA);*

2000 *Karta e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, Gazeta Zyrtare C 303 e 14 dhjetorit 2007;*

1995 *Direktiva 95/46/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 24 tetor 1995 për mbrojtjen e individëve lidhur me procesimin e të dhënave personale dhe për lëvizje të lirë të të dhënave të tilla,*

Gazeta Zyrtare L 281, 23 nëntor 1995.

II. Mekanizmat institucionalë të përfshirë në fushën e trafikimit me njerëz

Në Kosovë janë disa trupa dhe institucione, përfshirë edhe organizatat jo-qeveritare, përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin e politikave shtetërore për luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore, siç përshkruhen më poshtë.

Ministria e Punëve të Brendshme përmes mekanizmave si në vijim:

- Koordinatori Nacional Kundër Trafikimit;
- Sekretariati për Monitorim dhe Evaluim të Strategjive Nacionale (SMESN);
- Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim (DSHAM);
- Autoriteti Kombëtar Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore;
- Drejtoria për Hetimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore (DHTQNJ) në Policinë e Kosovës;

- Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial;
- Prokurori i Shtetit;
- Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë për Viktimat, në kuadër të Kryeprokurorit të Shtetit;
- Gjykata;
- Ministria e Drejtësisë;
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve;
- Komunat;
- Qendra për Punë Sociale, në kuadër të komunave;
- Ministria e Shëndetësisë;
- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit - përmes Programit;
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL);
- Strehimorja Shtetërore për Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Viktimave të Trafikimit me Qenie Njerëzore;
- Organizatat Jo-Qeveritare të licencuara nga ministrinë kompetente, me mandat në ofrimin e shërbimeve për personat e trafikuar, personat të supozuar të trafikuar dhe atyre në rrezik për trafikim (fëmijë dhe të rritur, vendore dhe të huaja) në Kosovë.

III. Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e trafikimit me njerëz

Me qëllim të parandalimit, luftimit të trafikimit me njerëz, asistimit dhe mbrojtjes së viktimave, institucionet e Republikës së Kosovës zhvillojnë forma të ndryshme të bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar, përfshirë edhe protokolle bashkëpunimi.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs

**PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE
KUNDËR TRAFIKIMIT ME NJERËZ NË KOSOVË
2022-2024**

29/03/2022

Nr.	Objektivat strategjikë dhe specifikë, treguesit dhe veprimet	Vlera bazë	Synimi i përkohshëm 2023	Synimi i vitit të fundit 2024	Rezultati				
1.	OBJEKTIVI STRATEGJIK I: Forcimi i mekanizmave institucionalë për luftim e trafikimit me qenie njerëzore (TQNJ)								
	Treguesi: Numri i aktorëve relevantë me kapacitete të ngritura në raportim dhe koordinim, si dhe rritja e efektivitetit të raportimit.	<i>Gjendja në vitin 2021</i>	2023 60%	2024 90%	Koordinim dhe raportim efektiv për ofrimin e shërbimeve cilësore dhe të qëndrueshme.				
I.1	OBJEKTIVI SPECIFIK I.1: Ngritja e kapaciteteve reaguese të të gjithë aktorëve relevantë për ofrim të shërbimeve cilësore dhe të qëndrueshme								
	Treguesi: Kapacitetet e ngritura të të gjithë aktorëve relevantë për ofrim të shërbimeve cilësore dhe të qëndrueshme.	<i>Baza</i> 2021			Së paku 150 profesionistë janë trajnuar për ofrimin e shërbimeve efektive dhe cilësore.				
Nr.	Veprimi	Afati i fundit	Buxheti			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Rezultati)	Dokumentet referente
			Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024				
I.1.1	Caktimi i anëtarëve në Autoritetin Kombëtar nga secili institucion/organizatë e interesit.		0.00	0.00	0.00	BK	Koordinatori Kombëtar (KK) MPB	Autoriteti Kombëtar (AK) i kompletuar me vendim.	Ligji kundër Trafikimit me Njerëz

I.1.2	Furnizimi i njësiteve të Policisë së Kosovës (DHTQNJ) me pajisje teknike.	2024				BK Donatorët	PK	70% të furnizuar me pajisje të nevojshme teknike.	Nevojat e identifikuar nga Policia e Kosovës
I.1.3	Profilizimi i stafit profesional në institucionet ku ofrohen shërbime për viktimat të trafikimit.	2024	0.00	0.00	0.00	BK	MFPT Komunat	70% e stafit të profilizuar në ofrimin e shërbimeve.	GRETA -Raporti i dytë për Kosovën
I.1.4	Rritja e burimeve njerëzore në QPS për trajtimin e rasteve të trafikimit.	2023				Donatorët BK	MFPT Komunat	Numri i përgjithshëm i punëtorëve socialë është rritur për 10%.	GRETA -Raporti 2021 Standardet minimale për ofruesit e shërbimeve për Viktimat e Trafikimit (VeT)
I.1.5	Fuqizimi i kapaciteteve njerëzore dhe teknike të linjës ndihmëse.	2024				BK Donatorët	ZMNV Donatorët	Tri (3) trajnime profesionale të mbajtura për trajtim të thirrjeve të pranuar.	GRETA -Raporti 2021 Standardet minimale për ofruesit e shërbimeve për VeT
I.1.6	Hartimi i udhëzuesit të brendshëm mbi rivlerësimin e vazhdueshëm të rrezikut për Qendrën për Strehim.	2023	2,280.00 mëditje dhe akomodimi 50 x 1 x 10= 500 x 3=1,500 Punëtorja me 10 vetë katër ditë plus 300 transporti	2,280.00	2,280.00	BK	QSMRVT	Një (1) udhëzues është hartuar dhe është në funksion të Qendrës për Strehim.	GRETA -Raporti 2021
	Buxheti i përgjithshëm për objektivin specifik I.1:		2,280.00	2,280.00	2,280.00				
	<i>Nga të cilat kapitale:</i>								
	<i>Nga të cilat rrjedhëse:</i>								

OBJEKTIVI SPECIFIK I.2:									
Fuqizimi i rolit të Koordinatorit Kombëtar, Sekretariatit të Strategjive dhe Autoritetit Kombëtar Kundër Trafikimit me Njerëz									
I.2	Treguesi: Përqindja e institucioneve anëtare të mekanizmave koordinues qendrorë të fuqizuar e që zbatojnë në mënyrën e duhur përgjegjësitë e përbashkëta koordinuese.	Gjendja në vitin 2021	2023 60%	2024 90%	Mekanizmat koordinues dhe monitorues qendrorë janë fuqizuar, janë funksionalë dhe efikas në zbatimin e veprimeve për parandalimin dhe mbrojtjen nga trafikimi me njerëz. Institucionet pjesëmarrëse të këtyre mekanizmave zbatojnë përgjegjësitë e përbashkëta në mënyrën e duhur.				
Nr.	Veprimi	Afati i fundit	Buxheti			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Rezultati)	Referenca në Dokumente
			Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024				
